



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"
VLORE
ZYRA E PROTOKOLL-ARKIVËS
Nr 5262 Prot
Datë 09.04.2019

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. _____ Prot.

Vlorë, më 28.03.2019

VENDIM


Nr. 17, datë 28.03.2019

**PËR
PLANIN E MASAVE PËR PËRMIRËSIMIN E VAZHDUESHËM TË CILËSISË NË
PROGRAMET E STUDIMIT DHE MËSIMDHËNIE NË UNIVERSITETIN "ISMAIL
QEMALI" VLORE**

Në mbështetje të shkronjës j të pikës 1 në nenin 38 në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe Vendimin e Senatit Akademik nr. 21, datë 08.05.2018, Senati Akademik në mbledhjen e datës 28.03.2019

VENDOSI:

1. Të miratojë ngritjen e grupit të punës, në nivel institucional, me qëllim përmirësimin e pyetësorit të studentëve për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi, me përbërje si më poshtë:
 - a. Zv/rektori për kërkimin shkencor dhe zhvillimin institucional;
 - b. Zv/dekanët akademikë për të katër njësitë kryesore;
 - c. 1 (një) përfaqësues i stafit akademik për çdo njësi kryesore;
 - d. 1 (një) përfaqësues i studentëve për çdo njësi kryesore;
 - e. 1 (një) përfaqësues i Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional.
 - f. 1 (një) përfaqësues i IT-së.
2. Parashikimin në projektbuxhet të një fondi me qëllim përmirësimin e laboratorëve didaktikë dhe infrastrukturës mbështetëse për rritjen e cilësisë së mësimdhënies.
3. Krijimin e moduleve me qëllim përpunimin kompjuterik të të dhënave statistikore të rezultateve të pyetësorëve.
4. Angazhimin e këtij grupi për hartimin e një pyetësori për vlerësimin e stafit ndihmësakademik në të gjitha nivelet nga stafi akademik.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

5. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Zv/rektori për kërkimin shkencor dhe zhvillimin institucional, Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional, njësitë kryesore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

NËNKRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. As. Elenica Pjero

